

# Shënimet e Konferencës



## Ne Besojmë te Krishti

**Presidenti Ouks** tha se ne besojmë te Jezu Krishti. Ai lexoi shumë shkrime të shenjta për atë që tha Jezusi gjatë jetës së Tij dhe kur vizitoi nefitët. Ne duhet t'i studiojmë fjalët e Jezusit që të na udhërrëfejné në jetë.

Kjo më mëson:



## Përsëri me Jezusin

**Plaku Stivenson** tregoi për dy vajza, tetoja e të cilave kishte vdekur. Bashkëshortja e Plakut Stivenson, Lesa, i pyeti se si po ndiheshin. Ato ishin të trishtuara, por i dhanë asaj dëshminë e tyre. Ato e dinin se tetoja e tyre ishte e lumtur dhe mund të ishte me Jezusin. Besimi te Jezu Krishti dhe jeta e përjetshme na ngushëllojnë.

Kjo më mëson:



## Dëshmi në një Autobus

**Plaku Korbit** foli për një grua me të cilën bisedoi gjatë një udhëtimit me autobus. Ajo e pyeti se përse ai besonte te Jezu Krishti. Ai nuk ishte i sigurt se çfarë të thoshte. Më pas vendosi të përqendrohej tek ajo që kishte më shumë rëndësi. Ai i tha asaj se ne kemi nevojë për Jezusin që të na ndihmojë të kthehemi tek Ati Qiellor. Edhe ne mund ta japim dëshminë tonë.

Kjo më mëson:



## Mbartja e Gurëve

**Motra Xhonson** tregoi se si mbajtja e gjërave të vështira në jetë është si të mbash një çantë shpine të mbushur me gurë. Ne mbartim gurë për shkak të mëkateve tona, dashakeqësisë së të tjerëve dhe sfidave të jetës. Jezu Krishti ndihmon për t'i zbratur çantat tona të shpinës nëse drejtohem tek Ai. Edhe ne mund të ndihmojmë për t'i lehtësuar çantat e shpinës së të tjerëve duke u kujdesur për ta siç do të kujdesej Jezusi.

Kjo më mëson:

